



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:064131
Datë: 16.01.2024
Numri i dokumentit: 05193948

C-IV-22-0111

Parashtruesi i kërkesës

**Autoriteti i Likuidimit (AL), NSH “Termosistemi”- Rahovec , (PRZ025) në likuidim
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), rr. “Dritan Hoxha” nr.55 Lakrishte, Prishtinë**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), gjyqtari Gazmend Sylaj, me 16 janar 2024, lëshon këtë:

AKTVENDIM

- REFUZOHET kërkesa e Autoritetit të Likuidimit të NSH “Termosistemi”- Rahovec, mbi mbylljen e rastit të likuidimit respektivisht që Autoriteti i Likuidimit të lirohet nga çdo detyrë e mëtutjeshme në lidhje me procedurat e likuidimit ndaj NSH “Termosistemi”- Rahovec.**
- Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 21 prill 2022, pranë DHPGJS, parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar Raportin Përfundimtar të mbylljes së procesit të likuidimit të NSH “Termosistemi”- Rahovec- PRZ025(tani e tutje subjekti raportues), pasi që ka ardhur në përfundim që kooperativa nuk ka asete te realizueshme, se janë përmbushur pothuajse të gjitha kërkesat kreditore të vlefshme si dhe nuk ka ankesa të regjistruara pranë DHPGJS.

Në propozimin e saj, AL pohon se tetë (8) kreditor, të cilëve ju është aprovuar kërkesat kreditore nuk janë paguar ende, për shkak siç thuhet të mos azhurimit të llogarisë bankare dhe mos qasjes së AL ndaj kreditorëve.

AL propozoj gjykatës që në pajtim me nenin 43 dhe nenin 46 të Shtojcës së Ligjit (nr. 04/L-034) për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (me tutje: Shtojca e Ligjit të AKP-së) pas shqyrtimit të

kërkesës të aprovojë Raportin Përfundimtar të dhe të merr vendim mbi lejimin e mbylljes së rastit të likuidimit ndaj kësaj ndërmarrje si dhe AL të lirohet nga çfarëdo detyre të mëtejme lidhur me subjektin e këtij raporti përfundimtar.

Për detaje të tjera referohet shkresave të lëndës.

Arsyetimi ligjor

DHPGJS, pas shqyrtimit të kërkesës, konsideron se nuk janë plotësuar kushtet ligjore sipas kërkesës së AL.

Sipas nenit 43 paragrafi 1, të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin 06/L-023, (nenin 26) Autoriteti i Likuidimit, pas përfundimit të plotë apo përfundimit substancial të realizimit të pronës së Ndërmarrjes sipas likuidimit, apo pas mbylljes së rastit të Likuidimit, i parashtron për informim raportin përfundimtar Bordit të Drejtorëve, para se të dorëzohet ky raport në Gjykatë nga Autoriteti i Likuidimit.

Paragrafi 2 i nenit 43 përcakton se Raporti përfundimtar përmban:

- 2.1. një listë të të gjitha pronave të shitura apo të zgjidhura në mënyra tjera,
- 2.2. një listë të fletëpranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme,
- 2.3. një listë përfundimtare të të gjitha kërkesave të lejuara duke shënuar në mënyrë të qartë shumat e shpërndara apo pronën e transferuar për përmbushjen e tërësishme apo pjesshme të secilës;,... dhe
- 2.4. një listë të balancit të mbetur në llogarinë bankare me shpjegim të qëllimit;

Paragrafi 3 i shtojcës së Ligjit bazik po ashtu i ndryshuar me Ligjin 06/L-023, (nenin 26) përcakton se:

“Autoriteti i Likuidimit, pas përfundimit të plotë apo përfundimit substancial të realizimit të pronës së Ndërmarrjes sipas likuidimit, apo pas mbylljes së rastit të Likuidimit, ia parashtron për informim raportin përfundimtar Bordit të Drejtorëve, para se të dorëzohet ky raport në Gjykatë nga Autoriteti i Likuidimit dhe Autoriteti i Likuidimit brenda pesë (5) ditëve do të shpall në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, Raportin Përfundimtar të aprovuar nga Gjykata për mbylljen e rastit të likuidimit të ndërmarrjes”.

Tutje sipas nenit 44 paragrafi 3 i të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, thuhet si një vijim:

“Me kërkesë të Autoritetit të Likuidimit, nëse asnjë kreditor nuk ka parashtruar kërkesë brenda Afatit të Fundit për Parashtrimin e Kërkesave, Gjykata nxjerr vendim për lejimin e mbylljes së rastit të likuidimit”.

Në vijim neni 45 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, thuhet:

“Pas mbylljes së rastit të likuidimit sipas nenit 43 të kësaj Shtojce, ndërpritet ekzistimi i Ndërmarrjes dhe Agjencia lëshon njoftim me shkrim lidhur me këtë për Komunën dhe institucionet dhe autoritetet publike të specifikuar në nenin 19.6.”

Sipas raportit të parashtruar nga ana e AL, lidhur me subjektin raportues, pohimeve të AL dhe shtojcës 17 të këtij raporti, shihet se AL me rastin e subjektit raportues (NSH “Termosistemi”) ndaj kreditorëve të listuar si në shtojcë nuk ka përmbushur obligimet monetare ndaj kreditorëve.

Arsyetimi i AL, fakti se subjekti raportues ka kreditorë të papaguar nuk e ndalon procesin e mbylljes së likuidimit gjykata e konsideron si të papranueshëm.

Fillimisht sipas dispozitës së cekur si më lartë (nenin 45) me rastin e mbylljes së likuidimit ndërpritet edhe ekzistimi i subjektit raportues, në këtë rast NSH “Termosistemi” e që me këtë rast subjekti raportues do të ishte jo-ekzistent në aspektin formal-juridik e që si rezultat i saj kreditorëve do të ju pamundësohej realizimi i të drejtave të tyre të aprovuara nga ana e AL. Në rastin konkret realizimi i të hyrave monetare të aprovuara nga ana e AL.

Po ashtu, gjykata konsideron se në rastin konkret, sipas nenit 46 paragrafi 1.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP, nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pushimin e AL ngase ky autoritet nuk ka bërë ekzekutimin përfundimtar të mjeteve monetare te tetë (8) kreditorët kërkesat monetare të cilat janë aprovuar.

Arsyetimi i AL se mjetet monetare nuk mund të shpërndahen për shkak të mos azhurimit të dhënave bankare nga ana e kreditorëve gjykata e konsideron si të papranueshëm dhe të paargumentuar andaj gjykata një arsyetim të tillë nuk mund ta pranojë.

E drejta në kompensim monetar në rastin konkret të aprovuar nga AL, sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; e aplikueshme sipas nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës konsiderohet si “pasuri” në kuptimin e Nenit 1 të Protokollit Nr.1 të Konventës, e cila është konfirmuar edhe në praktikën gjyqësore lidhur me Vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane mbi të drejtat e njeriut, të aplikueshme sipas nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës.

Andaj, nga gjitha arsyet e cekura si më lartë, shuarja e subjektit raportues, mbyllja e rastit të likuidimit dhe pushimi i AL, do të krijonte vështirësi të kreditorëve në realizimin e mjeteve të tyre monetare (gëzimin e së drejtës në pronë) dhe do të konsiderohej shkeljeve e dispozitave të cekura si më lartë, si ato të Shtojcës së Ligjit për AKP dhe dispozitës së Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut me Protokollet e saj.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Shpenzimet gjyqësore

Parashtruesi i kërkesës ka bërë pagesën e taksës gjyqësore dhe nuk caktohen shpenzimet tjera procedurale.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar